



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Integrimin European***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.07.2019, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636 datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit””.
2. Të tjera.

**Marrin pjesë:**

Senida Mesi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, , Ralf Gjoni, Aurora Mara, Andrea Marto, Arben Kamami dhe Klodiana Spahiu

**Mungojnë:**

Rudina Hajdari, Fatmir Velaj, Suzana Topi, Sadri Abazi,.

**Të ftuar:**

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Vjollca Braho – Kryeinspektore në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor.

Antoneta Njehrrëna – Drejtore e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## HAPET MBLEDHJA

**Senida Mesi** - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e ditës së sotme, datë 9.7.2019, të Komisionit për Integrimin Europian.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636 datë 6. 11. 2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit””.

Të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi zëvendësministren Mira Rakacolli, zonjën Vjollca Braho, kryeinspektore e Inspektoratit Shëndetësor, si dhe zonjën Antoneta Njehrrera, drejtore e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pa humbur kohë, dua t’ia kaloj fjalën zonjës zëvendësministre. Ju lutem, prezantoni shkurtimisht risitë e ndryshimeve në këtë projektligj. Më pas do ta kenë fjalën kolegët deputetë për pyetje apo për diskutime.

**Mira Rakacolli** - Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Duhani është i vetmi shkak i parandalueshëm i sëmundjeve, të cilat janë kryesore për vdekshmërinë në popullsi dhe për barrën e sëmundjeve që shkakton. Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton se brenda një viti vdesin shtatë milionë njerëz si rezultat i pirjes së duhanit, nga të cilët 900 mijë e marrin atë në mënyrë pasive. Mjafton të përmendet kjo shifër që të kuptohet se lufta kundër duhanit është një sfidë për të gjitha sistemet shëndetësore në të gjithë botën.

Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 2003 është bërë nxitëse për nënshkrimin e një konvente, që quhet Konventa e Luftës Kundër Duhanit, të cilës i është bashkuar edhe Shqipëria 2 vjet pasi ajo ka dalë.

Nga detyrimet që lindin nga nënshkrimi i kësaj konvente u bënë ndryshimet në ligjin për duhanin në vitin 2006, që e citoi zonja Mesi. Mendohet se ka qenë një ligj me influenza pozitive për sa i përket pakësimit të duhanpirjes në Shqipëri, por me kalimin e kohës është parë që nuk u shërben të gjitha problemeve që kanë dalë në këtë dhjetëvjeçar.

Nga një studim i bërë në vitin 2018, rreth 36% e meshkujve të moshës 16-49 vjeç janë përdorues të duhanit dhe 25% e vdekjeve janë shkaktuar nga përdorimi i tij. Nga ana tjetër, në këtë dhjetëvjeçar është shtuar shumë hyrja e produkteve, që nuk marrin etiketimin e duhanit dhe për pasojë nuk u nënshtrohen rregullave që janë të vendosura në ligjin aktual për sa i përket ndalimit të përdorimit të tyre, siç janë nargjileja ose shisha, por edhe cigaret elektronike.

Megjithëse në ligjin aktual ndalohet promovimi i produkteve të duhanit, kanë dalë mënyra që e bëjnë këtë promocion edhe pasiv. Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit aktual të duhanit është bërë i domosdoshëm. Në ndryshimet ligjore që ne propozojmë jemi munduar t'i përmbahemi krejtësisht direktivës europiane.

Ku konsistojnë këto ndryshime:

Ndryshmi i parë është në përkufizimin e saktë të atyre produkteve që njihen me emrin “duhan”. Në këtë përkufizim nuk vendoset vetëm ajo që ne të gjithë kemi parasysh, cigarja e zakonshme, por përfshihen edhe produktet e tjera, siç është nargjileja, shisha, cigarja elektronike apo duhani me ngrohje. Është krejtësisht në përputhje me direktivën europiane dhe ka si qëllim që këto produkte t'u nënshtrohen atyre ligjeve dhe atyre *reseksioneve* që i nënshtrohet edhe përdorimi i cigares së zakonshme.

Gjithashtu, është vendosur që në produktet inovative të duhanit, siç është cigarja elektronike, të vendosen limite në përqindjen e nikotinës. Edhe kjo është krejtësisht në përputhje me direktivën europiane. Nga ana tjetër, ndalohet shitja e cigareve me shije apo aroma të ndryshme, sepse mendohet që këto çojnë në shtim të përdorimit të duhanit. Pra, edhe ata të cilët nuk e pëlqejnë shijen e duhanit, duke pasur aroma të ndryshme mund të fillojnë ta përdorin. Kjo është krejtësisht në përputhje me direktivën europiane.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme edhe pika tjetër, që ne kemi vendosur në ligj, për detyrimin që iu vendoset prodhuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit, të përshkruajnë karakteristikat e tyre edhe për efektet negative që ato kanë në popullatë. Kjo është bërë, sepse ndonjëherë mund të ndodhë që Ministria e Shëndetësisë të mos informohet për llojin e produktit që hyn në treg, dhe në treg mund të regjistrohet një produkt që mund të ketë një bazë të madhe kancerogjene.

Ndryshimet e propozuara në ligj forcojnë masat që merren për ndalimin e promocionit të duhanit. Në çdo lloj supermarketi të gjithë kemi parë që te kasa janë të ekspozuara produktet e duhanit. Pra, pavarësisht se promocioni i duhanit është i ndaluar me ligj, gjetja e një mënyre të tillë është një reklamë shumë e mirë. Vetëm ta mendojmë sa herë në javë përballemi me këtë pamje dhe sa herë në javë fëmijët, të cilët mund të shoqërojnë prindërit ose mund të shkojnë vetë të blejnë, shoqërohen me këto pamje. Është një ndjellje shumë e madhe që ata të fillojnë të përdorin produktet e duhanit.

Kemi pasur një debat shumë të madh për dëmin që shkaktohet nga cigaret elektronike. Vazhdimisht industria e duhanit thotë që cigarja elektronike jo vetëm është më pak e dëmshme sesa cigarja e zakonshme, por është edhe një mjet që shërben për të bërë rrallimin ose lënien e

cigares së zakonshme. Në fakt, kemi bërë debat të madh për këtë. Nuk ka absolutisht asnjë studim të bazuar në evidencë që të tregojë qoftë mosdëmin e cigares elektronike, qoftë mundësinë që duke përdorur atë shkohet drejt lënies së duhanit. Prandaj, *reseksionet* karshi cigares elektronike në ndryshimet e ligjit aktual, që ne propozojmë janë po ashtu si te cigarja e zakonshme. Edhe kjo është krejtësisht në përputhje me direktivën europiane.

Të fundit, por jo më pak e rëndësishme nga ndryshimet që propozohen në ligj, janë masat që propozohet të merren për shkelësit e ligjit. Siç e thashë që në fillim, ligji i parë u zbatua, por, gjithsesi, u tregua që pavarësisht tij ne jemi dëshmitarë që vazhdohet të pihet duhan edhe nëpër ambiente të mbyllura.

Në ndryshimet që ne propozojmë, nëse një subjekt shkel nenin që ndalon pirjen e duhanit dy herë rresht brenda tre muajve, gjoba që do të paguajë në këtë rast do të jetë sa dyfishi i gjobës së parë. Ndërsa, nëse e përsërit të njëjtën shkelje brenda një afati njëvjeçar do të gjobitet me gjashtëfishin e gjobës, duke çuar deri në mbylljen e aktivitetit dhe heqjen e licencës për ato subjekte që gjobiten në mënyrë të vazhdueshme.

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet që sjellim sot në projektligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve nga produktet e duhanit” vijnë pas një serie konsultimesh që kemi bërë me grupet e interesit, tek të cilët patjetër që kanë ndikim këto masa.

Së pari, e kam fjalën për kompanitë që tregtojnë duhanin.

Prandaj, ne jemi dakordësuar që disa pika, siç janë paketat e reduktuara apo ato me shije karakteristike, që unë përmenda pak më parë, të hyjnë në fuqi nga 24 deri në 48 muaj që nga miratimi i ndryshimeve në këtë ligj.

Dua të ritheksoj se ky projektligj përafrohet me direktivën 2014/40/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, të datës 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të tij”.

Ne jemi në anën e shëndetit të qytetarëve, ndaj dua të theksoj se forcimi i masave të këtij ligji është tërësisht në funksion të shëndetit të popullsisë. Ne jemi të angazhuar maksimalisht për implementimin e tij në të gjitha nivelet, ashtu siç e kërkon edhe direktiva europiane në këtë rast.

Faleminderit!

**Senida Mesi** - Ju falenderoj, zonja Zëvendësministre!

Në fakt, shifrat që ju ndatë me ne (ju falenderoj edhe për ndarjen e statistikave) janë me të vërtetë shqetësuese.

Tani dua të vazhdojmë me pyetje nga ana e kolegëve deputetë. Personalisht kam edhe unë një pyetje, por po respektoj kolegët me qëllim ...

**Ralf Gjoni** – Ju falenderoj, zonja Zëvendësministre!

Për sa i përket përafrimit të legjislacionit me direktivën 2014/40/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, duke marrë shkas edhe nga eksperiencia në vendet anëtare të Bashkimit European, sepse nuk duhet të shikohet vetëm direktiva, por edhe eksperiencia e këtyre vendeve, ju keni sugjeruar që të ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Kjo prek jo vetëm cigaret dhe duhanin elektronik, por edhe produktet e nargjilesë, që janë produkte me mollë, të cilat janë të nevojshme për këtë lloj konsumimi të duhanit. Gjithashtu, ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve.

Nga cilat praktika europiane e keni marrë këtë sugjerim dhe pse është bërë ky sugjerim në ligj, ndërkohë që në vende europiane mund të blesh një paketë cigaresh me disa lloje shijesh. Pse mendoni ju se aromatizuesit e shtojnë varësinë e individit ndaj produkteve të duhanit? Me këtë propozim që keni bërë, më mirë të kishit propozuar që të ndalohej totalisht duhani në Shqipëri, sesa ky lloj penalizimi që ju iu bëni shumë konsumatorëve të këtij produkti.

Edhe cigaret elektronike, që janë me avull dhe që nuk përmbajnë nikotinë, preken nga ligji?

**Mira Rakacolli** – Faleminderit, për pyetjet!

Po e filloj me problemin e cigares elektronike.

Patjetër që cigarja elektronike ka nikotinë, bile mund të ketë nikotinë në sasi më të mëdha sesa e ka cigarja e zakonshme. Kjo është arsyeja që ne kemi vendosur në ligj edhe sasinë maksimale të nikotinës që mund të ketë. Cigarja elektronike nga cigarja e zakonshme ndryshon nga djegia. Në cigaren e zakonshme, përveç nikotinës, organizmi iu nënshtrohet edhe produkteve të dëmshme të djegies, kurse në cigaren elektronike eliminohet vetëm ekspozimi karshi produkteve të dëmshme të djegies, por jo të nikotinës dhe jo të disa substancave të tjera, të provuara tashmë që janë kancerogjene.

Unë do t'i referohesha këtu një studimi të konsultuar të Shoqatës Europiane të Sëmundjes së Frymëmarrjes, të cilin e kam me vete, që e konsideron cigaren elektronike, në lidhje me produktet që ajo ka, po aq të dëmshme sa edhe cigaren e zakonshme në lidhje me sëmundjet që shkakton në rrugën e frymëmarrjes dhe në dëmtimet që ajo jep në enët e gjakut.

Për sa i përket pyetjes së parë, për paketat me shije karakteristike, është e vërtetë që ka vende në Europë që i tregtojnë këto, por është po aq e vërtetë që ka edhe vende, të cilat e kanë të ndaluar këtë. Ne kemi marrë këto vende, të cilat e kanë të ndaluar, për faktin se arsyeja

që këto shije i vendosen duhanit, në radhë të parë është sepse bën që edhe ata njerëz, të cilëve nuk u pëlqen shija e cigares, por që e marrin ndonjëherë për ta provuar, e heqin këtë shije duke i dhënë një shije tjetër.

Pra, vendosja e një shijeje ka qenë një mjet që ka përdorur industria e duhanit për të shtuar konsumin e duhanit. Gjatë kohës së konsultimit të ligjit, sepse është një ligj i konsultuar gjerësisht, por edhe i debatuar gjerësisht me grupet e interesit që merreshin me prodhimin e duhanit, kemi bërë një debat dhe kemi rënë dakord që për këto cigare ky ligj të hyjë në fuqi 24 muaj deri në 48 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për sa i përket anës shëndetësore, ato janë po aq të dëmshme sa ato. Kjo është arsyeja që ne u jemi përmbajtur atyre vendeve, të cilat e kanë të ndaluar përdorimin.

Gjithashtu, ky është një rekomandim i Organizatës Botërore të Shëndetësisë të dhënë shprehimisht me shkrim nga zyra e përfaqësuesit që kemi ne këtu ministrisë sonë.

**Senida Mesi** – Më lejoni të adresoj një pyetje për përdorimin e duhanit në ambientet e mbyllura. Vitet 2013-2017 ishin një sukses për minimizimin deri në mospërdorimin fare të duhanit në ambiente të mbyllura. Vihet një re një trend, sikurse e përmendët edhe ju, që vazhdon të përdoret, bile është shtuar në disa ambiente të mbyllura përdorimi i duhanit.

Çfarë po bën Inspektorati Shëndetësor, në rastin konkret, pasi besoj se është institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe për marrjen e të gjitha masave të nevojshme që të respektohet ligji nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të mos shikojmë fenomene ku në disa institucione respektohet ligji dhe në disa institucione apo ambiente të tjera të mbyllura nuk respektohet ky ligj?

**Vjollca Braho** – Faleminderit për pyetjen!

Dua të theksoj se gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2019, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor janë marrë 298 masa administrative kundrejt 143 masave administrative që ishin marrë në po të njëjtën periudhë të vitin 2018. Pra, kemi një dyfishim të masave administrative.

Në këtë periudhë nuk përdor më njeri cigare në ambiente të mbyllura, por në ambiente të hapura, të cilave duke u vendosur vetrata i kthen përsëri ato në ambiente të mbyllura. Ambient i hapur quhet ai ambient që është 50% i hapur. Këto kanë qenë masat administrative që ne kemi marrë.

Ndryshimet ligjore që janë bërë në ligjin e ri janë të domosdoshme, pasi ka disa subjekte jo vetëm në Tiranë, por edhe në disa qytete të Shqipërisë, të cilat edhe pse kanë marrë një, dy apo tre masa administrative, përsëri vazhdojnë ta shkelin ligjin.

Pra, nëse brenda 3 muajve do të vendoset një masë e dytë administrative, atëherë masa administrative do të dyfishohet dhe nga 3 milionë do të shkojë në 6 milionë. Nëse brenda vitit

do të merret masa e tretë administrative, atëherë do të shkojë në 18 milionë lekë dhe deri në mbyllje përkohësisht të aktivitetit dhe pagimin e të gjitha masave administrative të marra në periudhën në të cilën është kryer kontrolli.

Në këtë periudhë, përveç punës që kanë bërë inspektoratet në të gjitha drejtoritë rajonale, unë kam ngritur edhe taskforcën antikorruption, e cila ka marrë edhe 115 masa administrative për shkelësit e ligjit.

Dua të theksoj se në rekomandimet që ka dhënë BE-ja, një nga ligjet që është zbatuar në të gjitha pikat është ligji i duhanit. Ky është rekomandim për vitin 2018 dhe vitin 2019. Puna jonë do të vazhdojë në mënyrë intensive dhe mendoj se në këtë periudhë është bërë një punë mjaft e mirë pasi rezultatet tregojnë se në gjashtëmujorin e parë kemi dyfishim të masave administrative në krahasim me vitin 2018.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Zonja Braho, ju falenderoj për përgjigjen! Në fakt, statistikat janë të bukura, shifrat tregojnë që ka punë të shtuar nga ana e Inspektoratit, por nuk tregojnë domosdoshmërisht që duhani nuk pihet në institucione apo në ambiente të brendshme. Unë ju sugjeroj dhe rekomandoj që pas orës 12:00 të natës të dërgoni taskforcën në pabe, klube apo ambiente të tjera publike, që të verifikojë nëse pihet duhan. Besoj se secili nga ne në këtë tavolinë, edhe ju vetë, e ka përjetuar një situatë të tillë.

Nuk e di nëse institucionet publike janë subjekt i monitorimit dhe kontrollit të Inspektoratit të Shëndetësisë, por ka një sërë institucionesh publike ku pihet duhan edhe në zyrat e drejtorëve. Unë, si një person që nuk pi duhan, e dalloj në moment nëse në atë zyrë pihet apo jo duhan.

Unë nuk them që ju inspektorët i keni të ndarë në duhanpirës apo jo, që të nuhasin me hundë nëse në iks ambient pihet duhan, por ligji duhet të respektohet në çdo institucion publik. Nëse nuk respektohet në institucionet publike ... Nuk e di sa përqind e atyre gjobave, që ju përmendët, janë marrë në institucionet publike. Institucionet publike të parat, qofshin qendrore apo lokale, duhet të japin shembullin e parë pozitiv dhe ju si institucion të jepni shembullin e paqe që po, nëse unë penalizoj institucionet publike, patjetër që do të penalizojë edhe institucionet private.

Është shumë komode të thuash të vendosim gjoba, t'i trefishojmë, t'i gjashtëfishojmë apo të mbyllim edhe aktivitetin privat. Nëse ky person shikon në zyrat e shtetit ku merr shërbime që pihet duhan ...

Ndoshta është e vërtetë ajo që thoni ju për ambiente gjysmë të mbyllura apo gjysmë të hapura, korridoret e të tjera, por për mendimin tim, edhe në korridoret e institucioneve apo në ambiente gjysmë të mbyllura quhet pirje e duhanit në ambiente të mbyllura.

**Vjollca Braho** – Keni shumë të drejtë, zonja Mesi!

Me porosi të zëvendëskryeministrit, zotit Erion Braçe, kemi bërë një bashkërendim të punës sonë për të kontrolluar jo vetëm institucionet shtetërore, por edhe ato private. Në institucionet shtetërore kemi marrë masa, duke filluar nga tatimet, Aluizni, doganat, policia, hipoteka, por edhe në institucione të tjera. Duhet të japim shembullin për institucionet shtetërore dhe pastaj më gjerë për publikun.

Dua të theksoj se në ligj nuk është vetëm Inspektorati Shtetëror Shëndetësor institucioni që merret me zbatimin e ligjit për të luftuar duhanpirjen, por janë edhe shumë institucione të tjera, duke filluar nga Inspektorati i Arsimit, i Punës, tatimet, doganat, Policia e Shtetit, Policia Bashkiake. Mund të them që këtë ligj e ka zbatuar vetëm Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, pra, Ministria e Shëndetësisë.

Masat që ne kemi janë të renditura. Me ligjin aktual subjekti merr 3 milionë lekë gjobë, 500 mijë lekë të vjetra gjobë i merr administratori, që është caktuar në të gjitha subjektet që mban përgjegjësi për pirjen e duhanit, kurse konsumatori 5 mijë lekë gjobë.

Duhet të theksojmë që ndërgjegjësimi është mjaft i rëndësishëm, sepse ne nuk mund të jemi në kohë reale... Numri i inspektorëve në të gjithë Shqipërinë është i vogël për të qenë në çdo subjekt ose ambient për të bërë këtë gjë. Duhet theksuar, se prandaj kemi ardhur në këto ndryshime ligjore. Shumëfishimi i gjobave do t'i bëjë njerëzit dhe të gjitha subjektet të mos e shkelin më ligjin.

Ju keni të drejtë edhe për klubet e natës. Përpara dy javësh, të premtën dhe të shtunën, ne dolëm për kontroll në të gjitha klubet e natës në Tiranë dhe vendosëm 43 gjoba, por të nesërmen ligji përsëri thyhet pasi vendoset vetëm 3 milionë lekë gjobë.

Shkallëzimi i gjobave që ne kemi vendosur këtu, duke i trefishuar dhe gjashtëfishuar, është domosdoshmëri. Kështu që, ne kemi ardhur këtu për ta miratuar këtë gjë dhe për të rritur akoma më tej punën tonë.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Zonja Mara dhe pastaj zoti Gjoni.

**Aurora Mara** – Faleminderit!

Ju përgëzoj për nismën, sidomos për nenin 3, ku parashikohet që prodhuesit dhe importuesit e produkteve të reja të duhanit duhet të lajmërojnë ministrinë përgjegjëse për produktet e reja që fusin! Personalisht nuk jam dakord me ndalimin e vendosjes në treg të



produkteve të duhanit me shije karakteristike. Më duket nonsens, në momentin që në treg ekzistojnë cigaret normale, të ndalojmë vetëm ato me shije karakteristike. Nuk evitojmë asgjë, vetëm sa ndalojmë shijen e duhanit. Janë thjesht shije duhani në momentin që duhani ekziston në treg. Me këtë nismë nuk jam dakord, kurse për të tjerat parimisht jam dakord.

Faleminderit!

**Ralf Gjoni** – Nuk shikoj gjëkundi në këtë propozim kontrabandën.

Ata që pinë cigare në Shqipëri e dinë shumë mirë që një shumicë dërrmuese e produkteve të duhanit në Shqipëri janë produkte ose të prodhuara në vende të treta, që nuk kanë asnjëlloj cilësie ose përafrimi cilësie me produktet e duhanit që shiten në vendet e Bashkimit European, ose dihet që janë produkte ndoshta të kontrabanduara, të infilttruara brenda territorit shqiptar me një përqindje shumë të lartë, në mënyrë anekdotale, sepse nuk e kanë provuar shkencërisht, arseniku dhe produktet e tjera shumë më të dëmshme sesa produktet e duhanit normal që konsumohet. A nuk do të ishte mirë që të përfshihej edhe një dispozitë për masat që duhen marrë kundër tregtarëve që tregtojnë ose kontrabandistëve që fusin produkte të rrezikshme në territorin shqiptar?

**Mira Rakacolli** – Po e filloj me pyetjen e zonjës Mara.

Siç e thashë edhe më parë, sepse pyetja është bërë më parë, problemi ka qenë një diskutim shumi i madh, por meqenëse këtu jemi në Komisionin e Integritetit doja të citoja shprehimisht që kjo është një kërkesë krejtësisht e direktivës europiane. Unë kam përpara Gazetën Zyrtare të Komitetit të Bashkimit European, ku citohet se duke filluar nga maji i vitit 2020 do të ndalohet në të gjitha vendet. Pra, është diçka krejtësisht në përputhje me direktivën europiane.

Për sa i përket pyetjes për kontrabandën, ky nuk është objekt i këtij ligji, por natyrisht që është shqetësim i qeverisë dhe është objekt i një ligji tjetër me të cilin po punon Ministria e Bujqësisë. Është objekt i ligjit që ka të bëjë me mënyrën e vendosjes së produkteve të duhanit, të tregtimit dhe marrjes së produkteve të duhanit në treg. Pra, nuk është objekt i ligjit me të cilin operon Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, por me të po punon Ministria e Bujqësisë.

**Senida Mesi** – Zonja Rakacolli, ju falenderoj!

Në fakt, është Kodi Doganor që adreson çdolloj kontrabande, kundërvajtje të ndryshme, pagesat dhe gjobat për atë që shkel ligjin. Aty janë të mirëpërcaktuara në detaje jo vetëm me kontrabandën, por edhe llojet dhe masat disiplinore që merren.

Për sa i përket përafrimit me legjislacionin e Bashkimit European, do të doja verdiktin e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit. Po, zoti Kasneci.

**Dedë Kasneci** – Faleminderit, zonja Zëvendëskryetare!

Siç u prezantua edhe nga zonja zëvendësministre, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9636 datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, i ndryshuar””, është përafuar me direktivën 2014/40 të Bashkimit Europian, të datës 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e duhanit dhe produkteve që lidhen me të”. Shërbimi ynë ka analizuar përputhshmërinë e këtij projektligji me nenet e direktivës dhe për një përafrim më të saktë kemi bërë disa sugjerime, të cilat, për efekt të kohës suaj, i kemi dakordësuar edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, të ndryshuar”? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ministria ka rënë dakord me ndryshimet e propozuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit?

Faleminderit!

Kalojmë në votimin nen për nen për propozimet e zotit Kasneci.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohen.

E votojmë ligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Falenderoj përfaqësuesit e ministrisë dhe ju uroj punë të mbarë!

Për axhendën e komisionit, dua të bëj me dije anëtarët e komisionit se nga Kryeministria i kanë ardhur për njoftim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Gjetjet e Rekomandimit të Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2019”.

Denisi do t’ju dërgojë me *e-mail* strategjinë, gjetjet për vitin 2019, si dhe planin e veprimeve të miratuar nga qeveria për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Besoj se kjo do të ngelet në kalendarin e sesionit të ardhshëm të Kuvendit, për ta filluar ndoshta në muajin shtator. Gjithsesi, do t’jua dërgojmë informacionin, pasi është voluminoz, në mënyrë që ju të keni kohën e mjaftueshme gjatë muajit gusht t’i hidhni një sy dhe ta analizoni.

Ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**